

VENDIM
Nr. 90, datë 7.2.2012

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SHITESË TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT,
NËNSHKRUAR MË 23 DHJETOR 2010, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE, DHE KFW FRANKFURT AM MAIN, PËR
FINANCIMIN E PROGRAMIT “INFRASTRUKTURA BASHKIAKE I” (FONDET E GRANDIT
IPA, 2010), SISTEMI I FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIME PËR QYTETET FIER,
GJIROKASTËR, LEZHË DHE SARANDË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes shtesë të marrëveshjes së financimit, nënshkruar më 23 dhjetor 2010, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e programit “Infrastruktura bashkiake I” (Fondet e grandit IPA, 2010), sistemi i furnizimit me ujë dhe kanalizime për qytetet Fier, Gjirokastrë, Lezhë dhe Sarandë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha